



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo

Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike
Mbledhja nr. 29
Prishtinë, më 04 nëntor 2011, në orën 09:00
Ndërtesa e Kuvendit, sala C-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR MBIKËQYRJEN E FINANCEVE PUBLIKE

Në mbledhje morën pjesë: Ali Sadriu, Ramiz Lladrovci, Valbona Dibra, Bali Muharremaj, Afrim Hoti dhe Albert Kinolli.

Munguan: Murselj Haljilji, Armend Zemaj dhe Adem Grabovci

Të ftuar: Lars Lage OLOFSSON – auditor i përgjithshëm, Dardan Gashi, ministër MMPH,

Stafi Mbështetës i Komisionit: Fatime Qorri - koordinatorë, KIPRED (staf mbështetës) - Albert Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi: Ali Sadriu - kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010,
3. Shqyrtimi i Propozim Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian për vitin 2012,
4. Të ndryshme

Kryesuesi konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetari propozoi që në rend dite të përfshihet edhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me datë 02 nëntor 2011, meqenëse është shpërndarë me kohë.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, njëzëri miratoi rendin e ditës me propozimin e kryetarit të Komisionit.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, mbajtur më 02 nëntor 2011

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike i miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 02 nëntor 2011.

3. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010

Kryetari- Tha se raporti i ZAP-it përmban disa vërejtje dhe rekomandime. Po ashtu në raport MMPH është pajtuar me këtë gjendje të konstatuar. Pyeti: a ka të njëjtin qëndrim ministria? Në raport flitet për një menaxhim të dobët dhe mospërfillje e rekomandimeve të ZAP-it. Nga nëntë rekomandime që janë dhënë në vitin 2009, vetëm një është implementuar, shtatë nuk janë shpalosur fare nga ministria, ndërsa për rekomandimin e tetë thuhet se është në proces, por që nuk dihet se në cilën fazë është. Kjo për Komisionin është alarmante, sepse shumë prej tyre janë përsëritur edhe në këtë vit. Pse nuk janë shpalosur këto rekomandime?

F.q 10-cilësia e informative – pasqyrat janë korrigjuar dhe janë dorëzuar për herë të dytë dhe prapë nuk janë në harmoni me Thesarin. Fq 11, ka mos-harmonizim midis departamenteve- realizimi i buxhetit ngrit çështjen e mungesës së evidencës rreth inkasimit të të hyrave. Ka mos-harmonizim të të hyrave nga departamente të ndryshme dhe mungesa e kontrollit të kompanive që merren me shfrytëzimin e ujit. Pse kanë ndodhur këto lëshime dhe kush është përgjegjës për evidencë, kontrolle të ndërmarrjeve dhe rreth harmonizimit të të hyrave të realizuara? Çfarë masash duhet të ndërmerren dhe çka ka paraparë me planin e veprimit ministria?

Blerjet përmes prokurimit ka probleme të shumta. Në 22 raste të ekzaminuara të kontratave nga ZAP, gjysma e tyre janë në kundërshtim me ligjin

Pati vërejtje për ZAP-in që nuk ka proceduar me kohë Planin e veprimit të ministrisë dhe kjo po e vë para situatave të paqarta Komisionin.

Dardan Gashi, ministër, MMPH- Tha se MMPH pranon vërejtjet dhe rekomandimet e dhëna nga ZAP-i. Në atë kohë ai nuk ka qenë përgjegjës. Lidhur me këtë duhet të përgjigjet sekretari përgjithshëm. Raportin e ka pranuar drejtpërdrejtë nga ZAP-i.

Tha se ministria ka bërë komente dhe i ka dërguar në ZAP. Raporti ka qenë temë diskutimi në takimin e parë të ministrit me sekretarin. Planin strategjik është hartuar menjëherë dhe janë dërguar te ZAP-i. Pse ato nuk janë në komision, për këtë duhet pyetur ZAP-in.

Ramiz Lladrovci – Tha se ministri nuk është përgjegjës për vitin 2010, por ZAP ka konstatuar dhe i ka dorëzuar këtë material ministrit. Pyeti: a e keni pasur këtë material dhe a keni vërejtur se rekomandimet nga viti 2009 nuk janë adresuar?

ZAP ka dhënë mundësi për të dhënë komente, ministria nuk ka bërë këtë. Të gjeturat sipas raporti janë pranuar nga ministria. Pyeti: Çka ka reflektuar apo do të reflektojë ministria lidhur me këto të gjetura? Opinioni i ZAP-it është jo i keq, mirëpo brendia ka defekte. ZAP është dashur ta sjell në mbledhje të Komisionit, personin përgjegjës në auditim.

Arben Çitaku, sekretar MMPH- Tha se Plani i veprimit që i është dorëzuar ZAP-it i adreson qartë rekomandimet e ZAP-it. Nëntë veprimet që potencon Komisioni kërkojnë kohë në përmbushje. P.sh punëtorët e Projektit Hade, që janë trashëguar para shtatë vitesh e që janë paguar nga kategoria mallra dhe shërbime – kjo ka kërkuar dy vite kohë për tu adresuar dhe për tu

përfshirë në sistemin e rregullt të pagave. Ky rekomandim është përmbushur në këtë vit. Këto gjëra janë diskutuar me ZAP-in dhe për adresimin e tyre është hartuar Plani i veprimit dhe në vitin 2011 këto do të jenë adresuar saktë.

Ministria është pajtuar me rekomandimet e ZAP-it. Pasqyrat financiare barazohen me thesarin dhe nuk ka asnjë mundësi që të ndodh diçka e tillë. Rekomandimi i të hyrave që kanë figuruar m vonesë kjo ka ndodhe kur MTI është porositur për shitje të veturave në ankand dhe pas tri raundeve të shitjes më ankand ato të hyra kanë figuruar me vonesë. Si të tilla janë përmirësuar pas draft raportit dhe opinionit tregon pasqyra të sakta financiare.

Vërejtja tjetër ka të bëjë me lejet ujore që ministria i jep për NP-të dhe lidhur me këtë ka disa konteste gjyqësore, sepse NP-të nuk e paguajnë me rregull tarifën dhe si të tilla figurojnë të hyra në MMPH. Çështja e dytë te pasuritë - bëhet fjalë për vetura të viti 2002, dhe në bazë të amortizimit ato nuk kanë vlerë. Ka paqartësi ligjore se si duhet të figurojnë në Free Balanc. Ato vetura janë shitur dhe është evituar ky problem.

Mujë Gashi – ZAP-i – Tha se çështjet e vitit 2009 janë ngritur në vitin 2010, ministria ka pasur vështirësi, por janë disa gjëra për të cilat nganjëherë duhet kohë për t'i adresuar. Projekti Hade-MMPH ka një njësi e cila merret me zhvendosjen e banorëve dhe këta punëtorë janë paguar nga kategoria mallra dhe shërbime. Sipas Planit të veprimit ministria është zotuar se kjo çështje nuk do të përsëritet dhe gjatë auditimit të ndërmjetëm auditorët kanë informuar se kjo çështje tashmë është kryer. MMPH ka pas vështirësi në implementimin e rekomandimit që ka të bëjë me harmonizimin e të hyrave. MMPH ka një plan ambicioz që të realizohet dhe në bazë të informatave që ka ZAP nga auditorët që janë duke audituar ministrinë shumë çështje tashmë janë adresuar.

Cilësia e informatave ka të bëjë me prezantimin e saktë të pasqyrave financiare. Realisht për prezantimin e pasqyrave financiar kanë pasur disa diskutime dhe me kohë janë adresuar, por shpalosja e të dhënave ka pas vështirësi sidomos në departamentin e të hyrave në ujëra. Të arkëtueshmet domethënë nuk janë shpalosur.

Proceset që kanë të bëjnë me njohje të të hyrave është që çdo dokument shkon përmes arkivës kjo ka qenë mos-harmonizim në mes të departamenteve brenda ministrisë. Në Planin e veprimit është adresuar saktë kjo.

Procesi i prokurimit duhet të menaxhohet më mirë, sepse kjo përfshinë nga inicimi i prokurimit e deri në përfundim. Pjesët kryesore që defektohen duhet të jenë pjesë e kontratës bazike. Pra specifikacioni teknik duhet të jetë më i detajuar.

Çështjet janë harmonizuar me ministrinë, komentet kanë të bëjnë me planin që ka bërë ministria për vitin 2010. Ky plan është i qartë dhe ZAP-i tani fillimisht do të merret me këtë plan. Auditimi ka filluar në këtë ministri për rishikimin e planit.

Mujë Gashi – ZAP përgatitë draft raport me të cilin ministria komenton. Ka çështje për të cilat ka pas harmonizim qëndrimesh me ministrinë.

Valbona Dibra – Pyeti: a ka marrë masa ministria për të vënë penalti ndaj NP-ve që nuk paguajnë borxhet. Kjo qoftë duke hartuar një UA me MZHE –në, që NP-të të detyrohen për pagesat.

Komisioni është i njoftuar për afatin dyjavor për komente të entitetit të audituar, në rastin konkret të ministrisë. Por, Komisioni duhet të ketë komentet në mënyrë që të ketë informacione se për cilat të gjetura ka pasur harmonizim dhe si ka qenë bashkëpunimi në mes të këtyre dy institucioneve.

Dardan Gashi – Tha se vlerësimi për MMPH është pozitiv dhe komentet e tjera janë sekondare. Jo me çdo kush duhet gjetur diçka negative në këtë ministri. Në ZAP janë dorëzuar të gjitha materialet obligative. Një pjesë e materialit i mungon Komisionit, domethënë pjesa e komunikimit në mes të ministrisë dhe ZAP-it.

Ramiz Lladrovci – Komisioni ka pranuar Plan veprimi të datës 28 shtator 2011, edhe ky plan është shumë i vonë. Komisioni e ka pranuar me datën 2 nëntor 2011 dhe pastaj është vetëm në gjuhën shqipe.

Komisioni nuk diskuton vetëm opinionin, por brendinë e informacioneve. Ka raste kur opinioni është i pakualifikuar, por brendia ka shumë të gjetura e për të cilin ka kërkuar që opinioni të jetë tjetër. Komisioni nuk ndërhyr në punën e ZAP-it, mirëpo kur Komisioni nuk pajtohet me raportet apo të gjeturat atëherë deklarohet lidhur me këtë. Komisioni ka caktuar tri seanca lidhur me këtë raport dhe nuk ka për qëllim që të nxjerr diçka të zezë domosdoshmërisht nga ky raport.

Kryetari – Gjendjen që ka konstatuar edhe auditimi i brendshëm ka konstatuar edhe ZAP-i. Ministria nuk ka reflektuar në rekomandimet e vitit 2009 dhe nuk ka reflektuar as në rekomandimet e auditorit të brendshëm. Nga materiali shihet që gjendja është shqetësuese. Tha se për gjendjen ekzistuese Komisioni ka materialin e duhur, por për Planin e veprimit se si do të tejkalohet kjo gjendje Komisioni nuk e ka këtë material.

Ministria nuk ka adresuar rekomandimet e viti 2009. Sa i përket rekomandimeve të viti 2010, Komisioni do të përcjellë këtë në vitin pasues. Të gjeturat e viti 2009, po përsëriten në vitin 2010. Propozoi që Komisioni të kërkojë një raport shtesë nga ZAP-i, me informacione rreth të gjeturave, ta diskutojnë Planin e veprimit, në radhë të parë rekomandimet e viti 2009, pastaj për vitin 2010, cilat janë të gjeturat, sa janë bartur nga viti 2009 dhe plani të shihet se a janë paraparë mekanizma adekuat për tejkalimin e kësaj gjendjeje. Materiali shtesë nga ZAP-i duhet t'i procedohet komisionit brenda muajit nëntor.

Alma Lama – Pyeti: a janë të sakta shkeljet të blerjet përmes prokurimit?

Bali Muharremaj – Tha se në bazë të diskutimeve në mbledhjen e Komisionit ka dallime shumë të mëdha, krahasuar me raportin e ZAP-it. Pa një raport shtesë Komisioni e ka të pamundur që të vendos sot.

Alma Lama – Lidhur me një raport shtesë nga ZAP-i tha se shkeljet janë pranuar nga ministria dhe përmirësimet e këtyre shkeljeve mund të konstatohen nga ZAP-i, në raportin e vitit të ardhshëm, atëherë kjo çështje duhet përfunduar.

Arben Çitaku, sekretar MMPH – MMPH ka adresuar çështjen e borxheve të NP-ve. Bëhet fjalë për vitin 2007 kur ka pasur thatësi. Çështja është proceduar të organet kompetente. Pastaj çështja me ambalazhuesit e ujit -kjo është bërë në marrëveshje që kjo të bëhet më këste ose diçka e tillë. Për ata që nuk i përgjigjen UA çështjet referohen në Gjykatë. Janë disa çështje që nuk varen vetëm nga MMPH. Vërejtjet janë pranuar, por ato nuk kane mundur të adresohen atëherë.

Çdo tre mujor MMPH barazon të hyrat me thesarin. Barazimi është vonuar se çdo departament krijon të hyra të veta, gjithashtu ministria ka autorizuar Divizionin e buxhetit dhe financave dhe tani çdo gjë është në rregull. Këtë e ka pranuar edhe ZAP-i. Ministria në organogramin e vet ka paraparë që Divizioni për buxhet dhe financa të ngritet në nivel Departamenti.

Sipas raportit në 11 lëndë të prokurimit ka vërejtje, por kjo nuk domethënë që janë në kundërshtim me ligjin, sepse shumica e vërejtjeve janë me defekte administrative e jo ligjore. Ministria ka pranuar që ka vërejtje, por këto janë çështje procedurale që mund të përmirësohen në vitet pasuese. Kjo i është thënë edhe ZAP-it. Mungesa e specifikacionit – servisimi i veturave- është e pamundur që të specifikohen të gjitha pjesët, por adresimi ka të bëjë që të gjitha pjesët e veturave që kanë defekte jashtë kontratës ministria do t'i paraqes në procedurë të rregullt të prokurimit. Për këtë janë pajtuar me ZAP-in. Komentet e ministrisë janë përcjellë në ZAP me datën 01 qershor 2011, menjëherë pas raportit final të ZAP-it.

Tha se me konkluzionin e përgjithshëm, ministria nuk është pajtuar. Lidhur me këtë Komisioni nuk ka informacion, por ka informacione vetëm për vërejtjet për të cilat ministria është pajtuar. Janë disa probleme që kanë të bëjnë me vakume ligjore, nuk mund të adresohen me kohë për këtë ministria ka bërë planin strategjik deri në vitin 2014.

Valbona Dibra- Lidhur me implementimin e rekomandimeve tha se në bazë të informatave që Komisioni mori nga përfaqësuesit e MMPH, del se përmbushja e këtyre rekomandimeve është e natyrës që kërkojnë kohë për përmbushje, me përjashtim të disa rekomandimeve administrative.

Ndau mendimin me kryetarin për një raport shtesë lidhur me implementimin e rekomandimeve dhe propozoi që të caktohet një afat për dorëzimin e këtij raporti, meqenëse Komisioni ka mungesë të materialeve shtese- konkretisht të komenteve të ministrisë.

Mujë Gashi – Raporti i ZAP-it është proceduar sipas obligimit. Plani i veprimit është proceduar në mbledhjen e kaluar, me të cilin ZAP-i ka dashur ta njoftoj Komisionin. Zotimet që ka bërë ministria do të vlerësohen me raportin e ndërmjetëm të auditimit.

Ramiz Lladrovci – Tha se Plani i veprimit është proceduar vetëm në gjuhen shqipe, pastaj Komisioni po shqyrton një raport të përgjysmuar në mungesë të informacioneve.

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri ka vendosur që ZAP-it t'i paraqes

Kërkesë

- *Zyra e Auditorit të Përgjithshëm në bashkëpunim me MMPH, të përgatisë raport shtesë lidhur me rekomandimet e ZAP-it për MMPH, lidhur me të gjeturat që janë bartur nga viti 2009 si të gjeturat e vitit 2010.*
- *Raporti duhet të përmbaj edhe planin e veprimit- a janë paraparë mekanizma adekuat për tejkalimin e kësaj gjendjeje?*
- *Raporti duhet proceduar në Komision më datën 20 nëntor.*

4. Shqyrtimi i Propozim Planit të Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian për vitin 2012

Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, shqyrtoi Propozim Planin e Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian për vitin 2012 dhe nxori këtë

Përfundim

- ***Miratohet Propozim Plani i Veprimit të Kuvendit të Kosovës për Integritet Evropian për vitin 2012,***
- ***Lidhur me sfidën P21 që parasheh se “auditimi i jashtëm ka nevojë të zhvillohet më tutje, pasi që ai shërben si motor i përmirësimit të administratës publike dhe sigurimit të përgjegjshmërisë”, Komisioni ka paraparë veprimin – Raport nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e jashtëm si dhe për auditimin e performancës.***
- ***Ky përfundim i dërgohet Komisionit për Integritet Evropian të Kuvendit të Kosovës.***

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike bazuar në faktin se raportet e auditimit të performancës paraqesin pasqyre reale për punën në institucione, njëzëri ka vendosur që ZAP-it t'i paraqes

Kërkesë

- *Zyra e Auditorit të Përgjithshëm në planin e punës së tij të parasheh shtimin e auditimeve të performancës.*

3. Të ndryshme

a). Rregullat e Brendshme të Procedurës të Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike

Kryetari konstatoi se Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike njëzëri nxori këtë

Përfundim

- 1. Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike do të hartoi rregullat e brendshme të procedurës për punën e Komisionit.***
- 2. Lidhur me pikën një të këtij përfundimi, Komisioni organizon punëtori dyditore në Prevallë, me datën 29-30 nëntor 2011.***
- 3. Shpenzimet barten nga Buxheti i Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike.***

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

E Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Ali Sadriu